



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 3.3.2020

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, datë 3.3.2020, për çështjen që i përket ankimit kundër vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me anë të cilit është konfirmuar në detyrë subjekti i rivlerësimit z. Adnand Kosova

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha shkaqet e ankimit, prapësimet e palëve dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, në përfundim, duke iu përmbajtur parashtrimeve të paraqitura në këtë gjykim, konstaton se pretendimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit nuk arritën të provojnë të kundërtën e shkakut të ankimit.

Për Komisionerin Publik, shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje nga ana juaj, mbi bazën e shkaqeve të ankimit, bazuar në nenin 179/b, pika 5, të Kushtetutës, nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe ligjin nr. 84/2016, provoi se:

I. Për sa i përket kriterit të pasurisë

1. Lidhur me pasurinë apartament banimi në posedim, me sip. 98 m², ndodhur në rrugën “*.***”, pallati i Gjykatës së Apelit, prenotuar me kontratë porosie individuale të datës ***.2.1998, i pahipotekuar dhe futur në procesin e legalizimit, me vlerë 19.600 USD (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind dollarë), subjekti i rivlerësimit:**

(i) nuk arrin të provojë me dokumentacion justifikues ligjor arkëtimin e shumës paradhënie prej 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh, që ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit 98 m², në rrugën “****.***”, Tiranë, shumë e cila nuk rezulton të jetë përcaktuar as në kontratën e shitblerjes apo në të kundërt.

Si rrjedhim i sa më sipër, në përputhje me nenin D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, nuk arrin të provojë bindshëm burimin e të ardhurave për krijimin e pasurisë së paluajtshme, apartament banimi me sipërfaqe 98 m², në rrugën “****.***”, Tiranë.

II. Kërkimi përfundimtar i ankimit

2. Në përfundim të këtyre parashtrimeve, në vlerësim edhe të përmbajtjes së rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik vlerëson se:

Për kriterin e pasurisë, në interpretim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të nenit 33, dhe pikës 3 dhe 5 të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare dhe nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë të deklaruar prej tij dhe personave të lidhur me të, duke kryer kështu deklaram të pamjaftueshëm.

3. Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, magjistrat/prokuror.

KOMISIONERI PUBLIK

Darjel SINA